



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 29 prill 2026

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 84.5/100 Përgjithësisht pozitiv

A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ministria udhëheqëse	MIE
Numri/data e RIAs	2026 – MIE – Nr.1
Statusi	Finalizuar
Data e marrjes për shqyrtim	11 mars 2026
Data e komenteve të fundit	28 prill 2026
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	22/19
Numri i ripunimeve	3

B) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është të miratojë disa ndryshime në përmbajtjen e neneve të ligjit nr. 54/2024 që lidhen me rregullimin e roaming dhe përfshirjen në legjislacionit shqiptar të acquis të roaming.

C) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyt e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe

lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë 2 mjaftueshmërisht cilësore dhe sasiore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar.

D) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë plotësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të përmirësoje formulimin e objektivave duke evidentuar qartë vlerën bazë, targetin e synuar, si dhe afatin brenda së cilit synohet arritja e objektivit.
2. Të zhvillojë më tej analizën cilësore dhe sasiore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare, sociale dhe mjedisore të opsionit të preferuar, mbi të gjitha grupet e prekura, duke plotësuar edhe shtojcat 2/a dhe 2/b të RIAs., sipas kërkesave të formatit dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit.